



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO
KUVENDI I KOMUNES - SKUPŠTINA OPŠTINE
DRAGASH - DRAGAŠ
ZYRA PËR PROKURIM – KANCELARIJA ZA JAVNU NABAVKU

Zyra per prokurim ne Dragash, ne baze te kerkeses per rishqyrtim te bere me date 23.02.2021 nga OE "Studio Hapsira" Sh.p.k -Prishtine , ne lidhje me aktivitetin e Prokurimit me nr: 621-21-60-221 " Hartimi I projekteve per nevojat e Komunes se Dragashit per 24 muaj " duke u bazuar ne Rregullat qe adoptojne,plotesojne dhe japin sqarime per paraqitje te kerkeses per rishqyrtim prane Autoriteteve Kontraktuese,parashtrim te ankesave prane OSHP-se dhe vlera e tarifave te ankesave si dhe duke u bazuar ne nenin 8.1.1 te kesaj rregulloreje-te aprovuara nga Komisioni Rregullativ I Prokurimit Publik I cili ne pajtim me Nenin 87,paragrafi 2,nen paragrafin 2.8 dhe nenin 118,paragrafi 1,te Ligjit mbi prokurimin Publik nr.04/L-042,I ndryshuar dhe plotesuar me ligjin nr.04/L-237,ligjin nr.05/L-068 dhe ligjin nr.05/L-092, bjen kete :

V E N D I M

- 1. Refuzohet kerkesa e OE "Studio Hapsira" -Prishtine e propozuar per rishqyrtim si e pa baze**
- 2. AK vendos te vazhdoj sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK per dhenie te kontrates te publikuar me date 18.02.2021.**

A R S Y E T I M

Lidhur me kerkesen tuaj per rishqyrtim te vendimit, Autoriteti Kontraktues konstaton se pretendimet tuaja jane te paqendrueshme jo te sakta dhe te pa bazuara ne LPP per arsyet si me poshte:



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO
KUVENDI I KOMUNES - SKUPŠTINA OPŠTINE
DRAGASH - DRAGAŠ
ZYRA PËR PROKURIM – KANCELARIJA ZA JAVNU NABAVKU

Ne pretendimin nr, 1:

Ku thuhet se OE I rekomanduar per kontrate nga AK ka dorezuar formularin dhe Listen e çmimeve te plotesuar jo ne rregull-Pozicionin 5, ne paragrafin B (Hartimi I projekteve ideore dhe kryesore-ndertimi I larte(15%),mungon nuk e ka plotesuar sasine,po ashtu kalkulimi I ketij pozicioni eshte 0,00 €.Ky pretendim eshte I pa sakt pasi qe ne tere dosjen e tenderit sasia eshte 1, ndersa ne kolonen e pozicionit 5 ne paragrafin B nuk ka te shenuar asnje sasi(leshim teknik nga ana e njesise se kerkeses), **prandaj per kete edhe kemi kerkuar sqarim:** nga OE te rekomanduar per kontrate ne sqarimin nga OE me pyetjen: Hartimi I projekteve ideore dhe kryesore poz. 5 ju keni ofruar ne poz. Per njesi vleren prej 0.01 €, kurse te shuma keni vendosur qmimin 0.00 €, ju lutem te na ofroni sqarime. **Pergjigjie dhe sqarim nga OE :** Ne paramasen e derguar nga AK tek pika 5,mungon sasia 1,andaj ne baze te LPP, ne si OE nuk kemi te drejte te nderhyjm ne paramase, e cila rrjedhimisht e ka sjellur edhe totalin prej 0.00 €, edhe pse ne kemi vendosur qmimin 0.01 €, tek pozicioni I qmimit, aty ku ne kemi te drejte te nderhyjme,andaj ky qmim total ka ardhur nga mungesa e sasise njesi 1.0 prej anes suaj.Ky sqarim nga OE eshte I drejte prandaj edhe ne total te qmimit eshte vendosur vlere e kalkuluar prej 0.01 € e cila ne total te qmimit te tere prap nuk e kalon vleren e permiresimit te gabimit ne kalkulim prej +,- 2%.Prandaj ky pretendim I juaji nuk qendron.

Pretendimi nr, 2:

Ne lidhje me elektroinxhinierin e kerkuar nga AK, ne dosje te tenderit eshte kerkuar inxhinier I elektros-drejtimi energjetik, por pa specifikuar qe ai nuk mund te jete edhe psh: Elektroenergjetik industrial, pra e pranueshme eshte vetem te jete inxhinier I drejtimit energjetik, prandaj edhe ky pretendim nuk qendron.

Pretendimi nr, 3:

Ne lidhje me pretendimin tuaj se mungon nje deklarate e nenshkruar nga te gjitha anetaret e grupit te cilet e autorizojne partnerin kryesor per te vepruar ne emer te grupit te bazuar ne NENIN 11.1 ne paragrafin C, edhe ky pretendim nuk qendron pasi qe nje deklarate e tille ekziston dhe eshte e nenshkruar ng ate gjitha anetaret e konzorciumit.



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO
KUVENDI I KOMUNES - SKUPŠTINA OPŠTINE
DRAGASH - DRAGAŠ
ZYRA PËR PROKURIM – KANCELARIJA ZA JAVNU NABAVKU

Pretendimi nr, 4:

Ne lidhje me pretendimin tuaj se Inxhinieri Agan Lezi-ingjinier I Elektos, Menagjeri I projektit Berat Murati-inxhinier I ndertimtarise dhe Astrit Salihu-inxhinier konstruktiv, ju mungon pervoja e punes ne menagjim te projekteve ne CV e ofruara. Edhe ky pretendim I juaji nuk qendron pasi qe te gjitha keta kane me teper se tri vite pune sipas kerkeses ne dosje te tenderit.

Edhe ne pretendimet tjera nga OE ankues shifet qarte se asnjera nga to nuk qendrojne pasi qe OE I rekomandur per kontrate I ploteson te gjitha kriteret sipas dosjes se tenderit te kerkuar. Per kete edhe ju si OE ankues e keni te tere dokumentacionin e OE te rekomanduar per kontrate te cilin e keni mar sipas te drejtes tuaj ne qasje te dokumentacionit.

Prandaj edhe nje here konstatojm se pretendimet tuaja ankimore nuk qendrojne dhe se:

Ne fund vendoset si ne dispozitiv te ketij vendimi.

Keshilla juridike: Pala e pa kenaqur sipas nenit 109 te ketij Ligji, mund te ankohet ne Organin Shyrtues te Prokurimit Publik te Kosoves ne afat prej 10 ditesh, nga marrja e ketij vendimi .

Dragash 25.02.2021

zyrtari pergjegjes per prokurim
Nuro Ismaili